



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANË

NR.RREGJ.THEM. 777
DATA RREGJ. 21.04.2017

DATE 22.04.2017

V E N D I M

NE EMER TE REPUBLIKES

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tiranë e perbere prej :

Gjyqtare : Arjana LIÇO

Asistuar nga sekretare gjyqsore **Ornela Kaja**, ne Tiranë me dt. 22.04.2017, mori ne shqyrtim materialin procedues qe i perket:

KERKUES : **Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë**, perfaqsuar nga prokurori **Ndini Tavani**.

KUNDER: **Shoqëria “T... M... W...”**, shoqëri tregëtare me Nipt K9...5V, me administrator **Z. T. T.**, në mungesë.

AKUZUAR: Për veprën penale të “Mashtrimit” parashikuar nga nenet 143/2, të Kodit Penal.

OBJEKTI: Sekuestrimin e shumave monetare pranë Bankave të nivelit të dytë, të shoqërisë tregëtare “M...”, me Nipt **L5...4G** në kuadër të procedimit penal Nr.2969/2017 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Baza Ligjore :Neni 210,214 të K.Pr.Penale

Gjykata pasi shqyrtoi kerkesen e prokurorit per Sekuestrimin e shumave monetare pranë Bankave të nivelit të dytë, në kuadër të procedimit penal Nr.2969/2017 të Prokurorisë

pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, të shoqërisë tregëtare “T... M... W...”, me Nipt K9...5V, me administrator Z. T. T. dhe pasi administroi provat shkresore;

VËREN

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tirane mbi bazen e kallezimit të shtetasit B. Rr.si dhe nga administrimi i materialit referues, ka regjistruar procedimin penal nr.2669 të vitit 2017, për veprën penale “Mashttrimi”, parashikuar nga neni 143/2, të Kodit Penal, në ngarkim të shoqërisë “T... M... W...”, shoqëri tregëtare me Nipt K9...5V, me administrator Z. T. T..

Nga hetimi gjyqësor rezultoi se:

Me datë 04.11.2009 është themeluar shoqëria T... M... W..., i pajisur me NIPT K 92...5V. Ky subjekt ka objekt të ushtrimit të aktivitetit të tij ‘dhenien me qera të kamionave dhe makinerive të zoteruara. Shërbime të menaxhimit të projekteve për germime dhe mimerë. Shërbime të supervizionit dhe menaxhimit të shfrytëzimit të M.... Me datë 23.07.2014 është emëruar administrator i këtij subjekti shtetasi T. T..

Me datë 07.01.2013 midis subjekteve T... M... W... shpk dhe M.Rr.i shpk, është lidhur kontrata e furnizimit për mallra.

Sipas kallezuesit kjo kontratë është respektuar nga palet pjesëmarrëse deri në kohën kur administrator i subjektit T... M... W... është emëruar shtetasi T. T.. Në këtë kohë kanë nisur konfliktet midis subjekteve dhe shtetasi grek T. T. ka refuzuar të paguajë subjektin furnizues për mallin e furnizuar si dhe ka zgjidhur në mënyrë të njëanshme me veprime konkludente kontratën e datës 07.01.2013.

Në këto rrethana kallezuesi i është drejtuar gjyqësit se shkallës së parë Krujë, duke kërkuar sigurimin e padisë, vendosjen e masës së sekuestros konservative mbi sendet e luajtshme, të paluajtshme dhe llogaritë bankare të të paditurit T... M... W... deri në vlerën 72.100.000 leke.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë me vendimin e saj nr 343, datë 12.03.2015, ka pranuar kërkesën e paditesit për sigurimin e padisë. Kjo masë siguri është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin e saj nr 321, datë 20.07.2015.

Në këto kushte përmbartësi gjyqësor privat Saimir Dogjani i është drejtuar bankave të nivelit të dytë me urdherin për vendosjen e sekuestros konservative sipas vendimit të gjyqësit se shkallës së parë Krujë. Ky urdher është depozituar në Tirnaa Bank me datë 03.04.2015.

Nga aktet bashkelidhur kallezimit rezulton se Tirana Bank, nuk ka respektuar vendimin e gjyaktës dhe urdherin e permbaruesit gjyqësor privat, pasi ka lejuar qe nga llogaria e subjektit T... M... W... shpk , te transferohen shuma te konsiderueshme parash per subjekte dhe persona te trete, ne kundërshtim me vendimin e gjyaktës, qe urdheronte bllokimin e llogarive bankare te ketij subjekti.

Sipas te dhenave te llogarise bankare te subjektit T... M... W... shpk, rezulton se ky subjekt, ka transferuar te subjekti M... shpk me date 13.01.2016, shumen 6.863.991,16 leke, me date 15.01.2016 shumen prej 12.176.587,31 leke, me date 20.01.2016 shumen 4.580.881,16 leke dhe po me date 20.01.2016 shumen 9.763.655,37 leke. Shuma e pergjithshme e trasferuar nga llogaria e T... M... W..., tek shoqeria M... shpk, eshte 33.385.114 leke.

Shoqeria M... shpk, eshte themeluar me date 03.11.2015 dhe eshte pajisur me NIPT L 5...4G. Objekt i ushrtimit te aktivitetit te ketij subjekti eshte “ *sherbimet e germimit dhe te M..., xheroreve dhe agregateve te tjere, tregetimi i makinerive dhe artikujve te tjere industriale me shumice dhe pakice. Perdorimi i lendeve shperthyese dhe eksplozive ne procesin e sherbimit te germimit dhe te M...*”. Ortake e vetme e ketij subjekti, eshte shtetasja greke Evangelia Stokou dhe administratore shtetasja greke Sofia Politidou.

Asambleja e ortakeve te shoqerise T... M... W..., me date 01.12.2015 ka vendosur miratimin e transferimit actual te shoqerise ne favor te shoqerise M... shpk.

Me date 09.12.2015, midis subjekteve T... M... W... shpk dhe M... Shpk, eshte lidhur kontrata e mareveshjes se bashkepunimit per transferimin e aktivitetit. Sipas kesaj kontrate vlera totale e asetëve te transferuara do te jete 137.714.357 leke dhe vlera totale e detyrimit te transferuar do te jete 137.560.000 leke. M... shpk , i detyrohet T... M... W... shpk, vleren 154.358 leke. SHOqeria M... shpk ka detyrimin te shlyeje te gjithe detyrimin prej 137.560.000 leke. Bashkelidhur kontrates, ndodhet dhe lista e plote e makinerive te transferuara nga T... M... Q... shpk, te M... shpk. Me date 01.12.2015 midis ketyre dy subjekteve, eshte perpiluar fatura tatimore e shitjes per transferimin e aktivitetit, sipas mareveshjes te dates 09.12.2015 ne vleren 104.010.807 leke.

Organi procedues ne analize te sa me siper dhe te analizes dh te akteve te tjera te ndodhura bashkelidhur kallezimit cmon se:

Veprimet e kryera nga subjekti T... M... W..., per te transferuar shuma te medha monetare te llogaria e subjektit M... shpk eshte kryer qe T... M... Shpk te mos reskeptoje vendimin e gjyaktës se shkalles se pare Kruje nr 343, date 12.03.2015, lene ne fuqi nga gjyakta e Apelit Tirnae me vendimin nr 321, date 20.07.2015, per sigurimin e padise dhe bllokimin e te gjitha

llogarive bankare te subjektit T... M... W... SHpk deri ne perfundimin e gjykimit me pale padites M Rr. shpk dhe te paditur T... M... W... shpk.

Organi procedues arrin ne kete perfundim duke analizuar aktet qe ndodhen bashkelidhur kallezimit, te cituara me siper si dhe ne aktet e tjera perkatesisht:

- Sipas informacionit te Institutit te Sigurimeve shoqerore , te Arkes Unike te Sigurimit te Qiramarresve te Republikes se Greqise, shtetasja E. S. rezulton te jete e siguruar si punonjese e T. T., qe rezulton administratori i vetem i subjektit T... M... W... shpk.
- Sipas listepagesave te kontributeve te Sigurimeve SHOqerore, rezulton se te gjithë punonjesit e T... M... W... shpk kane kaluar dhe paguhen nga M... shpk.
- Nuk rezulton nga aktet se M... shpk te kete paguar shuma parash per kalimin e pronesise se aktivitetit tregetar dhe te mjeteve, pasurive te laujtshme dhe makinerive nga T... M... W... SHpk.
- Te gjitha veprimet per transferimin e asetëve, aktivitetit dhe shumave te parave, rezulton se jane bere ne nje okhe te shkurter qe perkon me kohen e dhenies se vendimit nga gjykata e shkalles se pare Kruje me pranimin e padise se paditesit M.Rr. shpk

Perfundimisht organi procedues duke cmuar se ka dyshime te arsyeshme te bazuara ne prova, se shuma e parave ne vleren 33.385.114 leke transferuar nga T... M... W... shpk, te M... shpk, se nga subjekti T... M... W... Shpk, eshte kryer vepra penale e ‘Mashttrimit’.

Gjithashtu sa siper provohet se shtetasi T. T., po kryen veprime nepermjet transaksioneve bankare per te transferuar para dhe per te bere te pamundur ekzekutimin e vendimit te gjyakes se shkalles se pare Kruje nr 343, date 12.03.2015, lene ne fuqi nga Gjykata e Apelit Tirane me vendimin nr 321, date 20.07.2015.

Në këto kushte gjykata cmon se eshte e domosdoshme te sekuestrohen shumat monetare pranë pranë Tirana Bank dhe Bankave të nivelit të dytë, të shoqërisë tregëtare “M...”Shpk me Nipt L5...4G, në kuadër të procedimit penal Nr.2969/2017, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Sa sipër gjykata cmon se kerkesa e Prokurorisë së Rrethit Tiranë është e bazuar në prova e në ligj.

PËR KETO ARSYE:

Gjykata bazuar ne nenin 210 e 214 te K.Pr Penale.

V E N D O S I

- Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

- Sekuestrimin e shumat monetare pranë Tirana Bank dhe në të gjitha Bankat e nivelit të dytë, të shoqërisë tregëtare **“M...”Shpk, me Nipt L5..4G**, në kuadër të procedimit penal Nr.2969/2017, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

.-Ngarkohet Policia Gjyqsore, prane Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Tiranë per zbatimin e ketij vendimi.

- Autorizohet Prokurori Ndini Tavani, ose oficeri i Policisë Gjyqësore i autorizuar prej tij të kryejë sekuestrimin.

- Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 10 diteve nga e nesërmja e shpalljes së vendimit.

-U shpall sot, ne Tiranë me dt.22.04.2017.

SEKRETARE

GJYQTARE

ORNELA KAJA

ARJANA LIÇO